



VENDIM

Nr.79 Datë 24.07.2013

**PËR
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS -AL” SH.P.K
ME NR.118, SERIA PV11K, LESHUAR ME VENDIM TE BORDIT TE
KOMISIONEREVE TE ERE-S NR.07, DT.02.02.2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa”b”, pika 3 pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.07.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “ENERGY PARTNERS - AL” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.118, Seria PV11K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 07, datë 02.02.2011 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “ENERGY PARTNERS -AL” sh.p.k plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- ***Neni 15, pika 4, germa “a”:***

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. (është plotësuar tërësisht)

- ***Neni 15, pika 4, germa “b”:***

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit te cilat shprehin vullnetin për te kërkuar modifikim liçense. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Modifikimin e liçensës së shoqërisë “ENERGY PARTNERS-AL” me numër Nr.118, seri PV11K, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec-et “Shkalle”, “Cerrunje”, “Plesha”, ‘Bejni 1,2” dhe “Klos” me fuqi 72 KW, lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.7, dt. 02.02.2011.
2. Emerimi i Hec-ve do te jete : “Shkalle”, “Cerrunje 1”, “Cerrunje 2”, ‘Rrupe” dhe “Klos” Fuqia totale e instaluar e tyre do te jete 12,750 MW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI